


Statistikat Tregtare të Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Zvicër

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), bilanci tregtar me Zvicër¹, për vitin 2025, vazhdon rritja e bilancit pozitiv tregtar me rreth 11.8%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke u rritur në 51.1 milionë euro nga 45.7 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti mbetet e lartë me rreth 205.9%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Zvicër sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	70.1	75.6	86.3	99.4
Import	40.7	38.9	40.6	48.3
Bilanci tregtar	29.5	36.7	45.7	51.1
% e mbulimit	172.5%	194.3%	212.7%	205.9%
Rritje Exp. (v-m-v) %	25.2%	7.8%	14.1%	15.1%
Rritje Imp. (v-m-v) %	30.0%	-4.3%	4.3%	18.9%
Bila. Treg. (v-m-v) %	19.1%	24.5%	24.6%	11.8%


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

¹ Zvicëra, zyrtarisht Konfederata Zvicerane, është një vend në Evropën Qendrore, me kryeqytet Bernin. Ka një sipërfaqe prej 41,285 km², me rreth 9.2 milionë banorë. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) nominal për vitin 2026, vlerësohet me rreth 1,15 trilionë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 126,177 \$ (dollar amerikan), e renditur si ekonomia e 20-të për 2026, sipas Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Analizuar në periudhën e fundit katërvjeçare bilanci tregtar i Kosovës me Zvicër ka shënuar një rritje të vazhdueshme pozitive, duke u zgjeruar nga 29.5 milionë euro në vitin 2022, në 51.1 milionë euro në vitin 2025.

Ky trend rritës është mundësuar nga tejkalimi i vazhdueshëm i vlerës së eksporteve karshi importeve, gjë që pasqyrohet në një shkallë të lartë të mbulueshmërisë që qëndron vazhdimisht mbi 170%. Megjithatë, dinamika e rritjes së këtij bilanci pati një ngadalësim në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, si pasojë e një rritjeje më të hovshme të importeve prej 18.9% krahasuar me rritjen e eksportit prej 15.1%.

Figura 2. Eksport/Importi me Zvicër sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Zvicëra nga viti në vit zë një vend të rëndësishëm në eksportin e Kosovës, **gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara arrin në 99.4 milionë euro apo rreth 10.5% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm, renditet e 4-ta në listën e vendeve kryesore të eksportit.**

Importi i mallrave nga Zvicëra arritën në 48.3 milionë euro apo 0.7% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm.

Struktura e Eksportit/Importit me Zvicër në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesore të Eksportit e përbëjnë: 26.9% Artikuj të ndryshëm të prodhuar(mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj); 24.0% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 20.9% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 7.9% Druri dhe artikuj druri; 5.0% Ushqime të përg. pije, pije alkoholike dhe duhan; 4.5% Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi; 4.5% Makineri, paisje mekanike etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me Zvicër.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e eksporteve për 15.1% apo rreth 13.1 milionë euro më shumë mallra në tregun zviceran krahasuar me vitin paraprak. Metalet bazë dhe artikujt prej tyre kanë shënuar rritjen më të madhe strukturore, nga 20.5% në 24.0%, duke u bërë shtytësi kryesor i zgjerimit të eksporteve gjatë 2025 dhe një rritje e lehtë të Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre (nga 20.8% në 20.9%). Artikuj të ndryshëm të prodhuar (mobileri, krevate, dyshekë etj.) mbeten sektori kryesor eksportues me 26.9%, megjithëse pjesëmarrja e tyre është ulur lehtë nga 28.4% në vitin 2024 në 26.9% në vitin 2025.

Në përgjithësi, eksportet kosovare vazhdojnë të mbështeten kryesisht në industri prodhuese me përpunim të mesëm, si mobileri, metalet dhe plastika, tre sektorët përbëjnë rreth 72% të eksporteve në vitin 2025 (kundrejt rreth 70% në vitin 2024), çka tregon një përqendrim të lartë në pak sektorë, kjo e bën eksportin më të ndryshëm ndaj ndryshimeve të kërkesës në tregun zviceran.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 40.0% Produkte të industrisë kimike; 14.3% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 11.7% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 7.1% Instr.optike,mjeksore,fotog.,muzikore etj.; 4.7% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 4.2% Druri dhe artikuj druri; 3.6% Artikuj të ndryshëm të prodhuar (mobileri, krevat, dyshek, jastëk..) etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Zvicëra.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e importeve për 18.9% apo rreth 7.7 milionë euro më shumë mallra te importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Produkte të industrisë kimike (nga 27.2% në 40.0%), dhe një rritje e lehtë te Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 11.6% në 11.7%).

Dominimi i produkteve kimike dhe makinerive është rritur nga rreth 49% në vitin 2024 në rreth 54% në vitin 2025, duke treguar një varësi të shtuar të ekonomisë së vendit nga importi i mallrave nga Zvicëra, kryesisht produkte me përmbajtje të lartë teknologjike dhe kimike të cilat nuk prodhohen në masë në Kosovë.